

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
BH GROUP SHPK

09.09.2025



PERMBAJTJA

KAPITULLI I - EMRI, FORMA, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1 – Emri i Shoqerise

Neni 2 – Forma Ligjore

Neni 3 – Selia e Shoqerise

Neni 4 – Kohezgjatja

KAPITULLI II - OBJEKTI

Neni 5 – Objekti i Veprimtarise se Shoqerise

Neni 6 – Ndryshimi i Objektit

KAPITULLI III - KAPITALI THEMELTAR, PJESET E KAPITALIT, ORTAKET, TRANSFERIMI

Neni 7 – Kapitali Themeltar dhe Pjeset e Kapitalit Themeltar

Neni 8 – Ortaket

Neni 9 – Perjashtimi nga e Drejta e Votes

Neni 10 – Perjashtimi i nje Ortaku

Neni 11 - Transferimi i Pjeseve te Kapitalit

KAPITULLI IV – ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ORTAKEVE

Neni 12 – Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Neni 13 – Kuorumi dhe Vendim-Marrja

KAPITULLI V – ADMINISTRATORI

Neni 14 – Emerimi, Kohezgjatja e Mandatit dhe Shkarkimi

Neni 15 – Te Drejtat dhe Detyrimet e Administratorit

KAPITULLI VI – ADMINISTRIMI FINANCIAR I SHOQERISE

Neni 16 – Eksperti Kontabel i Autorizuar

Neni 17 – Viti Financiar

Neni 18 – Mbajtja e Llogarive

Neni 19 – Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit

KAPITULLI VII - NDRYSHIMI I FORMES LIGJORE, PRISHJA, LIKUJDIMI

Neni 20 – Ndryshimi i Formes Ligjore

Neni 21 – Prishja e Shoqerise

Neni 22 – Likuidimi

KAPITULLI VIII – TE NDRYSHME

Neni 23 – Ligji i Zbatueshem dhe Gjykata Kompetente

KAPITULLI I EMRI, FORMA, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1 Emri i Shoqerise

1.1. Emri i Shoqerise eshte **BH GROUP** ("Shoqeria"), ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "shpk", i cili perfaqeson formen ligjore te saj. Emertimi tregtar i shoqerise eshte "**BH GROUP**".

1.2. Ne te gjitha dokumentat, faturat, reklamimet dhe botimet e leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "shpk".

Neni 2 Forma Ligjore

2.1. Shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 3 Selia e Shoqerise

3.1. Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rr. Mihal Duri, ZK 8380, Nr. Pasurie 2/451-N10, Tirane.

3.2. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise.

3.3. Shoqeria mund te hap filiale, dege te saj, ose zyra perfaqesimi kudo, brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 4 Kohezgjatja

4.1. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje kohezgjatje te pacaktuar.

KAPITULLI II OBJEKTI

Neni 5 Objekti i veprimtarise se Shoqerise

5.1. Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete cdo lloj veprimtarie qe nuk ndalohet me ligj.

5.2. Shoqeria do te merret me importin dhe tregtimin e mjalitit.

5.3. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, ne menyre qe te arrihet qellimi i siperpermendur, Shoqeria mund:

- a) te kryeje cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin dhe per qellim te tij;
- b) te marre pjese ne tendera te te gjitha llojeve, brenda fushes se aktivitetit te saj, qofte per llogari te vet ose ne bashkepunim me cdo person fizik apo juridik, qofte shqiptar apo te huaj;
- c) te kryeje aktivitete tregtare, si dhe cdo transaksion ne lidhje me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, dhenie-marrje me qera, te vendose pengje dhe barre hipotekore/siguruese, qe mund te konsiderohen si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e Shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper;
- d) te kryeje cdo aktivitet qe lidhet me objektin kryesor te veprimtarise se Shoqerise.

Neni 6
Ndryshimi i Objektit

6.1. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe, ne respektim te dispozitave urdheruese te Ligjit per Shoqerite Tregtare dhe parashikimeve te ketij Statuti.

KAPITULLI III
KAPITALI THEMELTAR, PJESET E KAPITALIT, ORTAKET, TRANSFERIMI

Neni 7
Kapitali Themeltar, Pjeset e Kapitalit Themeltar

7.1. Kapitali i Shoqerise eshte ne total 100 (njqind) leke, i perbere nga 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 100% te kapitalit ("**Kuote**").

7.2. Shoqeria mund te leshoje nje certifikate per te vertetuar zoterimin e cdo Kuote ne Kapitalin e Regjistruar.

7.3. Shoqeria nuk mund te bleje apo zoteroje asnje Kuote te saj. Megjithate, me qellim zvogelimin e Kapitalit te Shoqerise, Asambleja e se Pergjithshme e Ortakeve, mund te autorizoj Administratorin/et te bleje pjeset e kapitalit perkatese me qellim anulimin e tyre.

7.4. Kapitali i Rregjistruar i Shoqerise do te zmadhohet dhe zvogelohet ne perputhje me dispozitat urdheruese te Ligjit per Shoqerite Tregtare dhe parashikimeve te ketij Statuti.

Neni 8
Ortaket

8.1. Ortake te Shoqerise jane vetem ata te cilet zoterojne Pjeset e Kapitalit te Rregjistruar te Shoqerise.

8.2. Ortak i Shoqerise eshte:

- **Shoqeri BH Group L.L.C**, e regjistruar rregullisht me nr. regjistrimi 811477498, ne Kosove, me date 05.11.2020, dhe zoteron 1 Kuote, me vlere 100 leke, qe perfaqeson 100% te kapitalit te Shoqerise;

8.3. Ortaku i Shoqerise nuk pergjigjet per detyrimet e Shoqerise dhe mbulon personalisht humbjet deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributet e ortakut/eve perbejne Kapitalin e Rregjistruar te Shoqerise.

8.4. Shoqeria nuk mban pergjegjesi per borxhe ose detyrime te tjera, me karakter vetjak, te Ortak/ut/eve te saj.

8.5. Cdo ortak ka te drejte vote ne perpjestim me vleren nominale te Kuotes te zoteruar prej tij.

8.6. Ortaku ka te drejte te marre informacione dhe te dhena ne lidhje me veprimtarine e Shoqerise, si dhe cdo kopje te cdo dokumenti ligjor ose financiar ne lidhje me Shoqerine, ne nje afat kohor te arsyesheshem pas kerkeses se tij me shkrim per dokumente te tilla dhe/ose informacione.

Neni 9
Perjashtimi nga e Drejta e Votimit

9.1. Ortaku i Shoqerise nuk mund te ushtroje te drejten e tij te votimit ne rast se Asambleja e Pergjithshme do te vendose ne lidhje me:

- Vleresimin e veprimtarise se tij si Ortak;
- Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te Ortakut ne fjale;



- Perfaqesimi i çdo lloj procesi gjyqësor kunder Ortakut;
- Dhenia e perfitimeve kundrejt ketij Ortaku.

Neni 10 Perjashtimi i nje Ortaku

10.1. Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje, me vendim te zakonshem, duke ju drejtuar me nje kerkese drejtuar Gjykates, per perjashtimin e nje Ortaku, nese ekzistojne shkaqe te arsyeshme per ta perjashtuar. Do te konsiderohen si shkaqe te arsyeshme, sa me poshte:

- Ortaku me dashje ose nga pakujdesia i shkakton deme Shoqerise ose Ortakeve te saj;
- Ortaku me dashje ose nga pakujdesia shkel Statutin, Ligjin Per Shoqerite Tregtare ose çdo ligj dhe/ose marreveshje tjeter ndermjet Ortakeve;
- Ortaku eshte ne nje suate te tille, e cila e ben te pamundur zbatimin e transaksioneve te biznesit ndermjet Shoqerise dhe Ortakut, si dhe permbushjen e detyrimeve te ketij te fundit kundrejt Shoqerise duke perfshire por pa u kufizuar ne mbeshtetjen financiare te Shoqerise;
- Ortaku, nepermjet veprimit dhe/ose mosveprimit, e ben te pamundur ose pengon interesat, emrin e mire dhe aktivitetin e Shoqerise;
- Abuzimi i Ortakut me te drejten e votes qe mund te shkaktoje nje dem potencial kundrejt Shoqerise, sikurse mund te vleresohet nga Asambleja e Pergjithshme kohe pas kohe;
- Veprim/e te kryera ne kundershtrim me parashikimet e sanksionuara ne Nenin 13 te Statutit;

10.2. Asambleja e Pergjithshme gezon te drejten qe te klasifikojë si “shkaqe te arsyeshme” cdo veprim, mosveprim, gjendje te Ortakut, kohe pas kohe, sikurse mund te kerkohet ne interesin me te larte te Shoqerise.

10.3. Shoqeria gezon te drejten e demshperblimit per demin qe ka pesuar per shkak te Ortakut te perjashtuar.

Neni 11 Transferimi i Pjeseve te Kapitalit (Kuotes)

11.1. Pjeset e kapitalit, jane lirisht te transferueshme midis Ortakeve.

11.2. Transferimi i Pjeseve te Kapitalit tek personat e trete, permes shitblerjes apo cdo forme tjeter ligjore me kundershperblim, apo per shkak te zbatimit te ligjit apo vendimeve gjyqësore, qe nuk bejne pjese ne Shoqeri, i nenshtrohet ketyre rregullave:

- Ortaku Transferues, duhet t'i njoftoje Shoqerise numrin/perqindjen e Pjeseve te Kapitalit qe do te transferohen, çmimin e shitjes ne rast shitjeje, bleresin potencial si dhe te dhena te tjera qe vleresohen thelbesore ne lidhje me transferimin e Pjeseve te Kapitalit.
- Transferimi duhet te miratohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve brenda 1 (nje) muaji nga data e njoftimit. Ne rast se Asambleja nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda afatit 1 (nje) mujor, miratimi quhet i dhene.
- Ne rast se Asambleja refuzon transferimin, brenda 1 (nje) muaji nga data e refuzimit, Ortak/u/et duhet t'i blejne Pjeset e Kapitalit te propozuara per transferim, proporcionalisht me pjeset e zoteruara ne kapital, pervec rastit kur bien dakort ndryshe. Cmimi i shitjes eshte çmimi i propozuar nga Ortaku Transferues ne piken a., ose nje cmim i ndryshem i rene dakort mes paleve.
- Ne rast se asnje Ortak nuk eshte i interesuar te bleje pjeset, atehere Asambleja duhet te vendose nese Pjeset e Kapitalit do ti shiten nje personi te trete, te zgjedhur nga Asambleja e Pergjithshme, sipas cmimit te propozuar nga Ortaku Transferues. Asambleja ka detyrimin te perzgjedhe bleresin jo me vone se 2 (dy) muaj nga data e shpalljes se vendimit te saj. Ne tejkallim te ketij afati, Ortaku eshte i lire te vijoje shitjen sipas paragrafit a. me siper.

11.3. Transferimi i Pjeseve te Kapitalit duhet te kryhet me nje akt te shkruar sipas kerkesave te ligjit.

11.4. Cdo transferim i kryer ne kundërshtim me rregullat e sipërpermendura është i pavlefshëm, dhe Ortaku Transferues do të jetë përgjegjës kundrejt Ortakeve të tjera dhe Shoqërise për dëmet e shkaktuara.

11.5. Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Pjesëve të Kapitalit transferohen tek cdo zotëruar i ri i këtyre Pjesëve të Kapitalit.

KAPITULLI IV ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKEVE

Neni 12 Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve

12.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi vendimmarës i Shoqërise dhe përbehet nga të gjithë Ortaket e Shoqërise.

12.2. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të shprehë mendimin e tij dhe të japë vota në përpjestim me vlerën nominale të Pjesëve të Kapitalit që ai zotëron.

12.3. Çdo Ortak ka të drejtë të përfaqësohet në Mbledhjen e Asamblese së Përgjithshme nga një person tjetër, jo domosdoshmërisht Ortak, me anë të një prokure të posaçme, të noterizuar dhe të pajisur me vule Apostile nëse është e nevojshme. Prokura e Posaçme mund të jepet vetëm për një mbledhje, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtën rend dite. Prokura e Posaçme duhet të përmbajë tagrat dhe menyrën e votimit të përfaqësuesit në Asamblenë e Përgjithshme.

12.4. Asambleja e Përgjithshme duhet të mbledhet të paktën një herë në vit, brenda muajit Qershor, me qëllim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e bilancit vjetor të vitit ushtrimor të mëparshëm. Asambleja e Përgjithshme mund të mbledhet në një vendndodhje të ndryshme nga selia e Shoqërise, brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.

12.5. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori, ose nga çdonjeri prej Ortakeve, që përfaqëson të paktën 5% të numrit total të votave, në përputhje me kërkesat e nenit 84 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

12.6. Njoftimi për thirrjen e Asamblese së Përgjithshme duhet të bëhet me leter rekomandë, me njoftim marrjeje, ose me postë elektronike në adresën elektronike të Ortakeve, të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Asamblese.

12.7. Njoftimi për thirrjen e Asamblese së Përgjithshme duhet të përmbajë informacion mbi çështjet që do të diskutohen dhe mbi të cilat do të merret vendim (Rendi i Dites), vendin, orën dhe datën e thirrjes së pare, si edhe procedurat e detajuara të pjesëmarrjes dhe të votimit, informacion mbi vendin dhe menyrat e marrjes së dokumentacionit dhe projekt vendimeve të Asamblese si edhe elementet e tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

12.8. Asambleja e Përgjithshme do të quhet e thirrur dhe e mbledhur rregullisht edhe nëse nuk respektohen të gjitha formalitetet e thirrjes, nëse të gjithë ortakët që përfaqësojnë 100 % Kapitalin e Shoqërise janë të pranishëm në mbledhje ose të përfaqësuar me prokurë, dhe shprehen dakort për të zhvillur Mbledhjen e Asamblese pavarësisht parregullsive në thirrjen e saj.

12.9. Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga Administratori, i cili emeron një sekretar për mbajtjen e procesverbalit të Mbledhjes. Administratori, në cilësinë e Kryetarit të Mbledhjes, ka kompetencë të plotë për të kontrolluar prokurat dhe rregullsinë e tyre, si dhe për të përcaktuar nëse asambleja është mbledhur rregullisht dhe

nese eshte arritur kuorumi i domosdoshem per te marre vendime te vlefshme. Kryetari ka gjithashtu te drejten per te drejtuar diskutimet dhe percaktuar metodat dhe procedurat e votimit.

12.10. Ortaket pranojne dhe bien dakord qe te marrin Vendime Qarkulluese me Shkrim, pa qene nevoja per te thirrur ne Asamblene e Pergjithshme. Draft-Vendimet e propozuara do t'u dergohen Ortakeve me poste te rregjistruar, fax, e-mail ose menyra te tjera elektronike te sigurta. Ortaket do te votojne ne lidhje me Draft-Vendimet, brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe ju eshte dorezuar ky Draft dhe do te miratojne Vendimet Qarkulluese duke i kthyer, me poste te rregjistruar nje kopje te firmosur, Administratorit te Shoqerise. Vendimi Qarkullues me shkrim do te konsiderohet i miratuar nese aprovohet nga shumica e kerkuar nga Ligji per Shoqerite Tregtare dhe ky Statut dhe Administratori shpall rezultat e tij.

12.11. Te gjitha Vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet te rregjistrohen ne procesverbale te cilat nenshkruhen nga Kryetari i Mbledhjes dhe Sekretari. Procesverbalit i bashkalidhet dokumenti i thirrjes se Mbledhjes se Asamblese i konfirmuar nga Ortaku dhe evidenca e pjesemarrjes se Ortakeve. Vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve depozitohen ne Rregjistrin e Vendimeve te Shoqerise. Vendimet e paregjistruara jane te pavlefshme.

12.12. Nese Shoqeria zoterohet nga nje ortak i vetem, te drejtat dhe detyrimet e Asamblese se Pergjithshme, te percaktuara ne kete Statut dhe ne Ligjin per Shoqerite Tregtare, ushtrohen nga ortaku i vetem.

Neni 13 **Kuorumi dhe Vendim-Marrja**

13.1. Ne rast vendimesh te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem Ortaket, zoterues te me shume se 30% (tridhjetete perqind) te Pjeseve te Kapitalit, me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mbledhet, per shkak te mungeses se Kuorumit ne thirrjen e pare, Asambleja mund te mbledhet perseri, me te njejtin rend dite, brenda dhe jo me vone se 30 (tridhjetete) dite nga thirrja e pare. Ne rast vendimesh te zakonshme, keto te fundit merren me voten pro te 51% te Ortakeve te pranishem.

13.2. Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te zakonshme per ceshtjet e meposhtme:

- o Vendosjen e Politikave Tregtare te Shoqerise;
- o Mbikqyrjen dhe monitorimin e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori, rishikon pergatitjen e Pasqyrave Financiare vjetore dhe Raporteve te ecurise se veprimtarise;
- o Miratimin e Pasqyrave Financiare vjetore dhe raporteve te ecurise ;
- o Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve;
- o Emerimi dhe shkarkimi i Eksperteve Kontabel te autorizuar dhe Likuiduesve;
- o Percaktimin e shperblimit te Administratorve, Eksperteve Kontabel, audituesve dhe Likuiduesve;
- o Perfaqesimin ne gjykate te Shoqerise dhe ne procedura te tjera kunder Administratoreve;
- o Miratimin e transferimit te Pjeseve te Kapitalit te Shoqerise tek palet e treta, jashte radheve te Ortakeve;
- o Pjestimin e Pjeseve te Kapitalit dhe anullimin e tyre;
- o Ndermarrjen e cdo veprimi i cili, rrezikon qe te coje Shoqerine ne likujdim ose falimentim;
- o Vendime ne lidhje me ceshtjet e parashikuara ne nenin 82 paragrafi 3, 4, 5, 6 te Ligjit per Shoqerite Tregtare, te cilat perfshijne vendime ne rastet kur:
 - Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim;
 - Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjithe aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara;
 - Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga nje Ortak, pasuri qe kane vlere me te larte se 5% e aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

- o Ceshtje te tjera qe parashikohen nga Ligji ose Statuti, dhe qe nuk perfshihen ne paragrafin 13.4. me poshte.

13.3. Ne rast vendimesh te jashtezakoneshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese jane te pranishem Ortaket, zoterues te me shume se 50% (pesedhjete perqind) te Pjeseve te Kapitalit me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet, per shkak te mungeses se kuorumit ne thirrjen e pare, Asambleja mund te mblidhet perseri me te njeitin rend dite, brenda dhe jo me vone se 30 (tridhjete) dite nga thirrja e pare. Ne rast vendimesh te jashtezakoneshme, keto te fundit merren me voten pro te 75% te Ortakeve te pranishem.

13.4. Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te jashtezakoneshme per ceshtjet e meposhtme:

- o Ndryshimin e Statutit te Shoqerise;
- o Zmadhimin ose zvogelimin e Kapitalit,
- o Shperndarjen e fitimeve vjetore;
- o Riorganizimin e Shoqerise ne nje forme tjeter, shperndarjen, shnderrimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, prishjen apo likuidimin e Shoqerise;

KAPITULLI V ADMINISTRATORI

Neni 14

Emerimi, Kohezgjatja e Mandatit dhe Shkarkimi

14.1. Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator. Detyrat dhe pergjegjesite e Administratorit jane te parashikuara ne Ligjin per Shoqerite Tregtare, ne Statut dhe ne Aktin e Emerimit.

14.2. Administrator i Shoqerise eshte Z.Flamur Lita, shtetas Shqiptare, lindur me 14.06.1971, ne Tirane, mbajtes i mjetit te identifikimit me Nr. 034718437 dhe numer personal H10614039F, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

14.3. Administratori zgjidhet nga Asambleja e Pergjithshme, sipas parashikimit te nenit 13.1 dhe 13.2. Vendimi i zgjedhjes dhe emerimit ne detyre te Administratorit, mund te jete edhe me vendim qarkullues me shkrim. Kohezgjatja e emerimit te Administratoreve eshte per nje periudhe prej 5 (pese) vjetesh, me te drejte riperteritje. Mandati i Administratorit te pare fillon ne date 09.09.2025 dhe perfundon ne date 09.09.2030.

14.4. Administratori mund te shkarkohet, ne cdo kohe, me miratimin e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, sipas parashikimeve te nenit 13.1 dhe 13.2.

14.5. Administratori/ja/et i nje shoqerie meme nuk mund te zgjidhet si Administrator i Shoqerise dhe e kunderta. Cdo emerim i bere ne kundershtrim me kete dispozite eshte absolutisht i pavlefshem.

Neni 15

Te Drejtat dhe Detyrimet e Administratorit

15.1. Administratori do te veproje i vetem, pra me firme individuale, ne lidhje me cdo ceshtje te Shoqerise, qe nuk kerkon miratimin e Asamblese se Ortakeve, dhe ne perputhje me kufizimet e percaktuara ne Statut dhe Aktin e Themelimit te Shoqerise. Cdo dhe te gjitha aktet e ndermarra ne kundershtrim me rregullat e vendosura ne Statutin e Shoqerise do te shpallen absolutisht te pavlefshme.

15.2. Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit perfshijne :

- (i) Thirrjen e Asamblese se Pergjithshme;
- (ii) Menaxhimin e aktivitetit tregtar te Shoqerise duke implementuar strategjite, politikat dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;

- (iii) Sigurimin qe Pasqyrat Financiare te mbahen ne menyren e duhur dhe firmosjen e bilanceve vjetore, llogarite e konsoliduara dhe raportet e performances, se bashku me rekomandimet per Asamblene e Pergjithshme per shperndarjen e fitimeve;
- (iv) Krijimin e nje sistemi paralajmërues, ne lidhje me ngjarjet qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (v) Depozitimn e te dhenave te Shoqerise prane Qenderes Kombetare te Biznesit sipas nevojës;
- (vi) Raportimin perpara Asamblese se Pergjithshme, ne lidhje me implementimin e politikave te biznesit dhe realizimin e transaksioneve me rendesi te vecante per Shoqerine, te cilat jane autorizuar paraprakisht prej Asamblese se Ortakeve;
- (vii) Te zbatojne detyra te ngarkuara nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve dhe Ligji sipas rastit.

15.3. Administratori mbikqyr dhe siguron qe zyrtaret, agentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise, veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne interesat e Shoqerise ne cdo rast.

KAPITULLI VI ADMINISTRIMI FINANCIAR I SHOQERISE

Neni 16 Eksperti Kontabel i Autorizuar

16.1. Asambleja e Pergjithshme emeron eksperte kontabel te autorizuar, ne rastet kur nje gje e tille kerkohet nga legjislacioni ne fuqi.

16.2. Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 17 Viti Financiar

17.1. Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-t te muajit Dhjetor te secilit vit.

Neni 18 Mbajtja e Llogarive

18. 1. Shoqeria do te mbaje llogarite ne monedhen **Leke**.

Neni 19 Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit

19.1. Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja e fitimit do te caktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me Statutin, dhe me ligjet e zbatueshme.

19.2. Nga fitimet vjetore, do te caktohet nje fond rezerve ne perputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar per fondin rezerve te detyrueshem.

19.3. Ne baze te Ligjit per Shoqerite Tregtare, Shoqeria mund te shperndaje fitimin tek Ortaket, vetem nese pas shperndarjes se dividendit:

- (i) Asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit, dhe
- (ii) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem.



KAPITULLI VII NDRYSHIMI I FORMES LIGJORE, PRISHJA, LIKUJDIMI

Neni 20 Ndryshimi i Formes Ligjore

20.1. Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim Unanim te Asamblese se Pergjithshme, ne perputhje me dispozitat perkatese te Legjislacionit Shqiptar dhe kete Statut.

20.2. Shoqeria e re do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

Neni 21 Prishja e Shoqerise

21.1. Shoqeria mund te priset ne rrethanat e meposhtme:

- (i) Ne te gjitha rastet e parashikuara nga neni 99 i Ligjit per Shoqerite Tregtare;
- (ii) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr.9723 date 3.05.2007;
- (iii) Me vendim gjykate;
- (iv) Per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe.

21.2. Administratori/et regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007. Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007, ia njofton vendimin Qendres Kombetare te Regjistrimit per regjistrim.

Neni 22 Likuidimi

22.1. Ne rast prishjeje Shoqeria duhet te likuidohet.

22.2. Per te administruar kete procedure, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve emerone nje ose me shume likuidatore, te cilet do te hartojne raportin perfundimtar mbi Aktivet dhe Detyrimet e Shoqerise, dhe mbi procedurat dhe kohen e duhur per likuidimin e Shoqerise.

22.3. Ne perfundim te procedurave te likuidimit, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te vendose mbi bilancin perfundimtar, punen e kryer nga likuiduesit dhe perfundimin e procesit te likuidimit.

22.4. Pas shlyerjes se kreditoreve dhe mbledhjes se kredive te mbetura, likuiduesit do t'u shperndajne Ortak/ut/eve aktivet e mbetura ne perpjestim me Pjeset e Kapitalit qe zoterojne.

KAPITULLI VIII TE NDRYSHME

Neni 23 Ligji i Zbatueshem dhe Gjykata Kompetente

23.1. Cdo ceshtje tjetere, e cila nuk eshte parashikuar ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite Tregtare.



23.2. Ortaket bien dakort qe cdo ose te gjitha mosmarreshjet qe linden ne lidhje me vlefshmerine, interpretimin apo zbatimin e Statutit te zgjidhen me mirekuptim midis Ortakeve dhe ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e mosmarreshjeve do te jete Gjykata Shqiptare.

23.3. Ky Statut eshte hartuar ne 5 kopje ne gjuhen Shqip, me vlere te njejte ligjore, sot me **09.09.2025**.

ORTAKU I SHOQERISE
BH GROUP L.L.C
Perfaqesuar nga Besart Humolli

Besart Humolli
(emer, mbiemer, nenshkrim)



